



Eshte luajtur java e XI per Kategorine Superiore dhe bashke me te eshte mbyllur faza e pare e kampionatit. Gjate kesaj faze nuk kane munguar surprizat me rezultate te paparashikueshme. Skenderbeu serish ka mundur te konfirmohet si skuadra qe te gjitha duhet te mundin nderkohe qe Teuta eshte bere pas 11 javeve rivalja kryesore e kampioneve. Spikat gjithashtu ecuria jo e mire e Kukesis qe pritej te bente shume me mire kete sezon nderkohe qe duket te jete e thelle kriza e Tiranës qe pas fazes se pare ndodhet ne vendin e fundit te tabelës duke rrezikuar renien. Gjate 11 javeve te para Xhafaj, Pejic dhe Bushic spikaten si shenuesit me te mire dhe gara per “Kepucen e Arte” duket se do te behet mes tyre. Kampionati do te nderpritet per gati dy jave per ti lene vendin ndeshjes miqesore qe kombetarja do te luaj ne Turqi me Bjellorusine.